



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2023



Komuna e Kaçanikut

### Procesverbal

Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Më 23.02.2023

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Sabedin Vishi**, Nënkyetar i Komunës

**Zahir Doda**, Drejtoria e Arsimit

**Halim Shehu**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Elmihane Malsiu**-HANDIKOS

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Ylber Tusha**-Përfajqsuesi i Bizneseve

**Fidaim Fazliu**-KBI

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pikë të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimërore
- 4.Trajtimi i rekondimeve nga takimt e KKSB gjat vitit 2022
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

### **2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë **Halim Shehu** i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Gjithsejtë kemi pasur 63 raste ku prej tyre 10 janë vjedhje,vjdhje e rëndë 15 raste , shpërdorim i pasurisë 4 raste, dëmtim i pronës 5 raste, kanosje 7 raste , sulm një rast, dhunë në familje në krahasim me periudhat e mëhershme kemi më pak gjithsejt tri raste , lëndim trupor dy raste , falsifikim i parashë dy raste, ngacmimë dy raste, lëndim aksidental një rast , përdorim i lëndëve narkotike një rast , përdorim i armës dy raste , tentim për vetvrasje një rast , pengim i zyrtarit në ushtrimin e detyrës një rast , incident në një ngjarje një rast , një vrasje , zjarrvënje një rast , tentim vjedhje dy raste , mashtrim një rast .

Sa i përket xhobave për parking ilegal gjithsejtë gjat kësaj periudhe kohore janë lëshuar 590 tiketa ku prej tyre ka pasur edhe për mos vendosjen e rrÿpit të sigurisë dhe për vozitje pa leje të vozítjes.

Nëpër shkolla gjendja e sigurisë është e mirë falë bashkëpunimit të mirë që kemi me institucionet arsimore.

Këto muaj ka rënë intenziteti i vjedhjes së pyjeve që ndoshta është edhe arsyaja se qytetarët janë furnizuar me masë drusore të kontrolluar nga institucionet e pylltarisë.

### **3.Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimërore**

-Në këtë pikë të rendit të ditës prezent ishte edhe Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia i cili tha se falë edhe kushteve atmosferike që kan qenë të mira deri më tanë nuk kemi pasur vështirsi të menaxhojmë situatën.

### **4.Trajtimi i rekondimeve nga takimet e KKSB gjat vitit 2022**

Lidhur me rkomandimet që janë dhënë nga viti i kaluar Kryetari tha se janë munduar si institucion të i zbatojnë por që kan mbetur dhe disa të tjera që besoj do të vazhdojmë të punojmë në realizimin e atyre rekondimeve që janë edhe si prioritet i komunës. Gjithashtu edhe Komandanti i Policisë tha se janë munduar që rkomandimet vitit të kaluar të i zbatojnë me përpikmëri me aq mundësi dhe potencial që kemi.

## 5.Të ndryshme

Në pikën e fundit të rendit të ditës me kërkesë të anëtarëve të KKSBB prezent ishte edhe inspektor i tregut i cili raportoi për punën që ka bërë gjat viti 2022

**Arben Fera:** ne si inspektorat vazhdimisht bëjmë inspektimë në biznese e kohëve të fundit aktiviteti jonë ka qenë në biznese që gravitojnë afër shkollave. Gjatë kryerjes së punës tonë ne kemi hasur edhe parregullsi në disa biznese sidomos shitja e duhanit fëmijëve që është e ndaluar me ligj dhe ndaj tyre kemi bërë edhe procese për masa ndëshkimore. Puna e inspektorëve është të hulumtojnë raste, të jepin vërejtje ndërsa hetuesinë e bënë tjetër institucion.

**Elmihane Malsiu:** ka informata se disa lokale biznesore afër shkollave përvëç disa produkteve ushqimore të lejuara servojnë edhe sendviqe dhe mua më intereson të dijë se a keni pasur raste të tillë dhe a është kontrolluar ndonjë lokal në lidhje me kushtet e punës për tu marrë edhe me këtë veprimtari.

**Arben Fera:** lidhur me këtë qështje mirret inspektori sanitari i cili tashmë ka kaluar në nivel regional.

**Zahir Doda:** më intereson të dijë se a keni të drejtë ju si inspektorë të hyni e të bëni një inspektim mbrenda një lokalit ku dyshohet se ka parregullsi. Mua më intereson sidomos dukuria e shitjeve me copë që është brengosëse ngase nxënësit janë ata që shërbehen nga pronarët e këtyre bizneseve.

**Arben Fera:** sigurisht se e kemi atë të drejtë dhe nëse hasim probleme e ftojmë edhe policinë në asistim. Sa i përket shitjeve së cigareve me copë ne nuk mundemi ta ndalojmë por që nëse prindi dhe mësimdhënësit në prezencë të nxënësve jepin deklaratë se shitësi e ka shërbyer fëmijën atëher ne mundemi të ndërmarrim masa.

**Nënkryetari:** ne duhet të punojmë në preventivë ngase dukuria e shitjeve së cigareve me copë është bërë dukuri brengosëse

**Fidaim Fazliu:** siç u tha edhe nga parafolësit dukuria e shitjeve së cigareve me copë është brengosëse ngase janë fëmijët të cilët ju ekspozohen kësaj dukurie andaj duhet të veprojmë ligjërisht në pengimin e kësaj dukurie sepse nuk besoj që ndonjë mësimdhënës mundë të lajmëroj ndonjë rast.

Bengosëse është edhe pirja e duhanit nëpër hapsira shkollore nga nxënësit dhe vet stafi arsimorë dhe dua të dijë se a janë marrë masa në këtë drejtim për të parandaluar kët dukuri.

**Zahir Doda:** Pirja e duhanit është e ndaluar me ligj nëpër të gjitha hapsirat e myllura të institucioneve dhe në bazë të disa informacioneve që kam është e ndaluar edhe në hapsira të jashtme të objekteve shkollore. Mbrenda objektit shkollor nuk ka ndodhur që ndokush nga stafi arsimor dhe nxënësit e shkollave të dal jashtë këtij ligji që ndalon pirjen e duhanit.

**Halim Shehu:** kohëve të fundit për shkak të kohës së mirë janë mbushur trotuaret me karrige e tavolina nga kafiteritë që po pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve. Ne si polici kemi dalë në aksion dhe u kemi dhënë vërtje pronarëve të kafiterive që kët gjë mos ta përsërisin. Gjithashtu disa biznese vendosin reklama në trotuare dhe parkingje që gjithashtu është është një dukuri e ndaluar dhe në momentin që inspektorët komunal kërkojnë asistimin tonë ne do të jemi të gatshëm për bashkëpunim.

**Kryetari:** është e vërtet se kohëve të fundit janë mbushur trotuaret me karrige e tavolina nga pronarët e kafiterive dhe inspektorët komunal gjithashtu kan dalë në teren dhe u kanë dhënë vërejtjet e fundit dhe besoj se kjo dukuri nuk do të përsëritet.

**Nënkrytari:**dukuria e vjedhjeve është një dukuri shqetësuese për shoqërinë dhe me intereson të dijë nga komandanti i policisë se a është ndërmarrë diqka në identifikimin dhe kapjen e autorëve.

**Halim Shehu:**është punuar në këtë drejtim dhe disa recidivistë janë duke e vuajtur dënimin por që shqetësuese është hezitimi për ofrimin e të dhënavë nga qytetarët.

**Naim Hysa:**shqetësim i madh për banorët e fshatit Stagovë është vendupnishtja e INFRAKOS e cila nuk ka ndërmarrë kurrfarë masa për të evitar ndonjë rrezik të mundshëm.Makineria e rëndë qarkullon nëpër mes rrugës e trotuareve e ngarkuar dhe pa mbulesë ,mungesa e shenjave sinjalizuese dhe mungesae shiritave është një pakujdesi e kompanisë së vendpunishtës ngase po rrezikojnë edhe fëmijët që lëvizin në këtë teren.Kërkoj nga komuna dhe nga policia të dalin në teren dhe të njoftohen më mirë me gjendjen reale.Kjo dukuri është prezentë edhe në qytet sidomos rrugës që të shpie te shkolla fillore „Emin Duraku”(Dushkajë).

**Halim Shehu:**kemi pasur ankesa nga banorët e kësaj ane dhe patrollimet e policisë në këtë pjesë janë 2 deri 3 herë në ditë dhe gjithashtu kemi kontaktuar edhe punëkryesin që të ju përbahet rregullave të sigurisë gjatë punimeve që bëjnë në këtë pjesë.

**Nënkyetari:**Ne si komunë kemi bërë inqizime dhe raport të gjendjes reale, kemi kontaktuar edhe me zyrtarë nga ministria dhe INFRAKOS dhe na është premtuar se do ta menagjojnë si duhet situatën gjatë punimeve dhe çdo gjë që është dëmtuar do të riparohet por që diçka me shkrim nuk kemi ende.

#### REKOMANDIMET

- 1.Të inspektohen bizneset lidhur me respektimin e kushteve sipas rregullave në fuqi dhe të tregojnë kujdesë maksimal ndaj produkteve që tregojnë.
- 2.Të mirren masa ndaj bizneseve që u shërbejnë fëmijëve produkte të duhanit dhe pije alkoolike .
- 3.Të respektohet ligji kundër pirjes së duhanit në hapsira të mbyllura.
- 4.Të merren masa ndaj pronarëve të kafiterive të cilët përdorin trotuaret për shërbime e reklama.

Kryesuesi:Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka